

**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Legjislatura III**

Kryesia e Kuvendit të Kosovës  
P-004  
Prishtinë, më 13 shkurt 2008, në orën 11:30  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E  
GRUPEVE PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 13 SHKURTI  
2008**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Slobodan Petrović, Xhezair Murati, kurse mungoi (me arsye) Xhavit Haliti.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Bojan Stojanović, Zylfi Merxha dhe Aridan Gjini.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu;

Nga NDI-a: Rinor Beka dhe Ian Perkins; dhe

Nga OSBE-ja: Petrit Hysaj.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

**Nexhat Daci** propozoi që në rend dite të jetë edhe çështja e caktimit të këshilltarëve për anëtarët e Kryesisë, të cilët do të jenë staf mbështetës për vëllimin e madh të punëve, që do t'i kenë anëtarët e Kryesisë.

**Ibrahim Makolli** propozoi që në rend dite të jetë edhe shqyrtimi i kërkesës për plotësimin e kushteve të punës së grupeve të reja parlamentare.

**Kryesia** nuk i miratoi këto dy propozime shtesë.

**Sllobodan Petroviq** propozoi që në seancën e radhës Kuvendi të vendosë edhe për anëtarët e komisioneve parlamentare nga radha e Grupit Parlamentar SLS.

Kryesia e miratoi propozimin e Sllobodan Petroviqit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet sipas këtij:

## **R e n d i t ë d i t e s**

- 1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës:**
- 3. Të ndryshme:**
  - 3.1** Shqyrtimi i kërkesës së anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, Ibrahim Gashi, për caktimin e shoferit personal,
  - 3.2** Njoftimi i Grupit Parlamentar “7+” lidhur me emërimin e deputetit Zylfi Merxha kryetar të Grupit “7+”,
  - 3.3** Nisma për hartimin e Projektregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës
- 4. Pikat shtesë të rendit të ditës:**
  - 4.1** Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të AAK-së për zgjedhjen e Naim Maloku anëtar të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës,
  - 4.2** Njoftimi me ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese nga ana e PSSP- së,
  - 4.3** Mocion i G/P të Kuvendit të Kosovës për formimin e Komisionit Ad-hoc për shqyrtimin e P/L nga Pakoja e Ahtisarit dhe miratimi i të njëjtave me procedurë të shkurtër,
  - 4.4** Shqyrtimi i propozimit për shmangien e afateve nga Rregullorja për miratimi e Projekt Buxhetit për vitin 2008,
  - 4.5** Shqyrtimi i propozimit për emërimin e zëvendësministrave,
  - 4.6** Njoftim lidhur me publikimin e rezultatit të votimit përmes votimit me sistem elektronik,
  - 4.7** Shqyrtimi i kërkesës së anëtarit të Kryesisë, Nexhat Daci, për lejimin e caktimit të shoferit

personal.

## **1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të 28 janarit 2008 u miratua pa vërejtje.

## **2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës**

**Kryetari** i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës. Ai kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë të rendit të ditës. Kryetari propozoi që seanca e radhës të mbahet më 15 shkurt 2008.

**Ardian Gjini** propozoi që pyetjet parlamentare, të parashtruara për seancën e datës 15 shkurt 2008, të shtyhen për seancën tjetër, për shkak të numrit të madh të çështjeve që pritet të shqyrtohen gjatë seancës së radhës, si dhe të bëhet një rirenditje e propozimit të rendit të ditës për seancën plenare.

**Nexhat Daci** e përkrahu propozimin për shtyrjen e pyetjeve parlamentare dhe propozoi që të shtyhet për një seancë tjetër edhe shqyrtimi i projektligjeve që kanë arritur në Kuvend, përveç Projektligjit për Buxhetin e vitit 2008 .

**Kryesia** i miratoi propozimet e cekura më lart.

**Kryesia**, vazhdoi me shqyrtimin e rendit shtesë të ditës.

### **3.1 Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të AAK-së për zgjedhjen e Naim Malokut anëtar të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe**

### **3.2 Njoftimi me ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese nga ana e PSSP-së,**

**Kryetari** i informoi të pranishmit lidhur me Vendimin e PSSP-së për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese dhe plotësimin e Kryesisë me anëtarin e nëntë, në bazë të të cilit Grupi Parlamentar AAK-së ka bërë propozimin për emërimin e anëtarit të Kryesisë nga kjo parti, me kërkesë që Kuvendi të vendosë në seancën e radhës.

**Kryesi** vendosi që kjo kërkesë të shqyrtohet në seancën e datës 15 shkurt 2008.

### **3.3 Shqyrtimi i Mocionit të grupeve parlamentare për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuar në Propozimin gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari për zgjidhjen e Statusit të Kosovës**

**Kryetari** i njoftoi të pranishmit se pesë grupe parlamentare: Grupi Parlamentar i PDK-së, Grupi Parlamentar i LDK-së, Grupi Parlamentar i AKR-së, Grupi Parlamentar i LDD-së dhe Grupi Parlamentar i AAK-së kanë paraqitur një mocion përmbajtjesor me të cilin kanë kërkuar që ligjet që dalin nga Pakoja e Ahtisarit të miratohen nga Kuvendi i Kosovës në procedurë të shkurtuar, ndërsa për shqyrtimin e këtyre ligjeve kanë propozuar të formohet një Komision ad-hoc i përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare.

**Kryetari** e hapi debatin lidhur me këtë propozim.

**Sabri Hamiti** e shtroi dilemën lidhur me kërkesën për krijimin e Komisionit ad-hoc, duke thënë se kërkesa për krijimin e këtij Komisioni mund të jetë shkelje e të gjitha dispozitave, sepse bën përjashtimin e të gjitha komisioneve funksionale të Kuvendit dhe në fund e përjashton edhe Kuvendin. Ai, gjithashtu, shtoi se asnjë nga ligjet e Pakos së Ahtisarit nuk duhet të aprovohen para aprovimit të Kushtetutës së Kosovës.

**Nexhat Daci** e përkrahu propozimin e përsheptimit të miratimit të ligjeve, që dalin nga Pakoja e Ahtisarit, por shprehu dilemat lidhur me Komisionin ad-hoc dhe propozoi që Mocioni të formulohet më saktë dhe më qartë, e pastaj t'i paraqitet Kuvendit për miratim.

**Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deklaroi se e mbështet në tërësi Mocionin e paraqitur dhe propozoi Fehmi Mujotën dhe Selvije Halimi për anëtarë të Komisionit ad-hoc nga ky Grup Parlamentar.

**Eqrem Kryeziu**, në emër të Grupit Parlamentar LDK-së, deklaroi se e mbështet në tërësi Mocionin e paraqitur dhe propozoi Lutfi Hazirin dhe Haki Shatrin për anëtarë të Komisionit ad-hoc nga ky Grup Parlamentar.

**Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar AKR-së, deklaroi se e mbështet në tërësi Mocionin e paraqitur dhe deklaroi se kryetari i këtij grupi të jetë anëtar i Komisionit ad-hoc..

**Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deklaroi se e mbështet në tërësi Mocionin e paraqitur dhe propozoi që kryetari i këtij grupi të jetë anëtar i Komisionit ad-hoc.

**Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deklaroi se e mbështet në tërësi Mocionin e paraqitur dhe propozoi që kryetari i këtij grupi të jetë anëtar i Komisionit ad-hoc.

**Xhezair Murati**, në emër të Grupit Parlamentar të “7 +”, deklaroi se e mbështet në tërësi Mocionin e paraqitur.

**Bojan Stojanoviq**, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, kërkoi nga Kryesia kohë që të konsultohet me të gjithë anëtarët e Grupit Parlamentar lidhur me Mocionin e propozuar.

**Kryesia**, pas diskutimeve, vendosi që Mocioni i GP të radhitet për shqyrtim në seancën plenare të radhës.

### **3. 4 Shqyrtimi i propozimit për marrjen e vendimit për shmangien e afateve të Rregullores së Punës të Kuvendit për miratimin e Projektligjit për Buxhetin e vitit 2008**

**Kryetari** i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Projektligji për Buxhetin e vitit 2008 u është shpërndarë deputetëve më 11 shkurt 2008, ndërsa më 12 shkurt 2008, Kryeministri i Kosovës ka bërë kërkesë që Projektligji për Buxhetin e vitit 2008 të shqyrtohet, të miratohet dhe të dërgohet për shpallje te PSSP-ja para datës 26 shkurt 2008.

**Kryesia** vendosi që propozimin për shmangie të Rregullores t'ia paraqes Kuvendit në seancën e radhës, për miratim.

### **3.5 Shqyrtimi i propozimit për emërimin e zëvendësministrave**

**Kryetari** i njoftoi të pranishmit lidhur me propozimin e Kryeministrit të Kosovës për emërimin e katër zëvendësministrave :

- Usmen Baldazhi, zëvendësministër i Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë,
- Ljubisa Zhiviq, zëvendësministër i Ministrisë së Drejtësisë,
- Sasha Rashi, zëvendësministër i Ministrisë së Punë të Brendshme,
- Raif Elezi, zëvendësministër i Ministrisë së Administrimit të Pushteti Lokal.

**Kryesia** vendosi që propozimi për emërimin e zëvendësministrave të radhitet për shqyrtim në seancën e radhës.

### **3.6 Njoftimi lidhur me publikimin e rezultateve të votimit me sistem elektronik**

**Kryesia** u njoftua se nga seanca e 15 shkurtit 2008 do të bëhet publikimi i votimit elektronik në web-faqe të Kuvendit dhe në media.

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, vendosi që Kuvendit t'ia paraqes këtë

#### **R e n d d i t e:**

1. Njoftim lidhur me publikimin e rezultatit të votimit përmes sistemit elektronik,
2. Shqyrtimi i Mocionit të grupeve parlamentare (5) për shmangie nga Rregullorja e Punës së Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuar në Propozimin gjithëpërfshirës nga Pakoja e Ahtisarit për zgjidhjen e Statusit të Kosovës,
3. Shqyrtimi i Propozimit për shmangien e afateve nga Rregullorja e Punës së Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e Projektligjit për Buxhetin e vitit 2008, si dhe procedimi i tij,
4. Shqyrtimi i Propozimit të Grupit Parlamentar të AAK-së për zgjedhjen e Naim Malokut anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës,
5. Shqyrtimi i Propozimit të Kryeministrit për emërimin e zëvendësministrave
6. Shqyrtim i Propozimit të Grupit Parlamentar të SLS-së për zgjedhjen e dy anëtarëve në komisionet parlamentare.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet pa praninë e kryetarëve të grupeve parlamentare.

### **4. Shqyrtimi i pikave të ndryshme:**

#### **4.1 Njoftimi i Grupit Parlamentar “7+” për emërimin e deputetit Zylfi Merxha kryetar të këtij grupi**

**Kryesia** u njoftua lidhur me emërimin e deputetit Zylfi Merxha kryetar i Grupit Parlamentar “7 +”, për gjashtë muajt e ardhshëm.

#### **4.2 Shqyrtimi i kërkesës së anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit Ibrahim Gashi dhe Nexhat Daci për caktimin e shoferit personal**

**Kryetari** i informoi të pranishmit lidhur me kërkesën e anëtarëve të Kryesisë: Ibrahim Gashi dhe Nexhat Daci për caktimin e shoferit personal. Ai kërkoi nga sekretari i Kuvendit sqarime lidhur me kërkesat e parashtruara.

Sekretari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë se për momentin realizimi i kësaj kërkesë do të jetë ngarkesë për buxhetin.

**Kryesia** vendosi që në të ardhmen çështja e shoferëve personal për anëtarët e Kryesisë të rregullohet me Rregulloren e Punës së Kryesisë të Kuvendit, e cila është duke u hartuar.

#### **4.3 Nisma për hartimin e Projekt-Rregullore së Punës së Kryesisë**

**Kryesia** u njoftua se është duke u përgatitur Projekt-Rregullorja e Punës së Kryesisë dhe Projekt-Rregullorja për Stafin Politik të Kuvendit.

**Kryetari** e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 13:25.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Jakup KRASNIQI**

---

E hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**